ODA E INXHINIERËVE
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës
Komora inženjera Republike Kosovo
Chamber of Engineers of the Republic of Kosovo
Njësia org. / Org. Jedinica / Org. Unit: OIRK
Nr. i faqeve / Br. Stranica / No. of pages: /
Nr. i Prot. / Broj Prot. / Prot. No.: 639/26
Data / Datum / Date: 05.11.2026
PRISHTINË / A No.1

ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS (OIRK)

Për:

- Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor – Kabinetin e Ministres
- Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë
- Komisionin Ministror për Themelimin e Odave (KMTHO)

Lënda: Njoftim për pezullimin e përkohshëm të aktiviteteve të OIRK-së për shkak të mungesës së financimit për vitin 2026

Të nderuar,

Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (OIRK) ju njofton se Bordi Drejtues, si organ ekzekutiv i Odës, në mbledhjen e datës 3 nëntor 2026, me vota unanime ka vendosur pezullimin e përkohshëm të aktiviteteve dhe shërbimeve administrative të OIRK-së, përfshirë mbylljen e zyrave, deri në sigurimin e financimit të nevojshëm për rifillimin e funksionimit të rregullt. Pezullimi i punës dhe shërbimeve administrative të Odës fillon më 5 nëntor 2026.

Ky vendim është marrë me keqardhje, si pasojë e gjendjes së rënduar financiare dhe mungesës së mjeteve që nga korriku 2026, ndërkohë që granti i paraparë për vitin 2026 ende nuk është realizuar.

Për sqarim, planifikimi buxhetor i OIRK-së për vitin 2026 është dorëzuar në Ministri më 21 tetor 2025, sipas kërkesës së Komisionit Ministror për Themelimin e Odave (KMTHO). Më 17 qershor 2026, OIRK ka kërkuar procedimin e Memorandumit të Mirëkuptimit dhe, pas kërkesës së Ministrisë më 1 korrik 2026, ka dorëzuar draftin përkatës më 2 korrik 2026. Më 5 gusht 2026, KMTHO ka kërkuar sërish planin e shpenzimeve për vitet 2026 dhe 2027, sipas formatit të bashkëngjitur në email. Në përgjigje të kësaj kërkese, më 10 gusht 2026, OIRK ka dorëzuar planin e përditësuar të shpenzimeve për të dy vitet, të përgatitur sipas formatit të kërkuar nga KMTHO, së bashku me dokumentacionin përkatës financiar. Përmes shkresave të datave 2 dhe 15 shtator 2026, OIRK ka njoftuar Ministrinë për gjendjen financiare dhe vështirësitë në përmbushjen e detyrimeve, duke kërkuar përshpejtimin e procesit të financimit. Më 28 tetor 2026, pas takimit të zhvilluar në Ministri, gjatë të cilit janë kërkuar disa sqarime dhe korrigjime shtesë, OIRK i ka realizuar dhe dorëzuar korrigjimet e kërkuara po atë ditë, duke përcjellë në Ministri versionin përfundimtar të Memorandumit të Mirëkuptimit, tabelat e përditësuara dhe sqarimet përkatëse. Që nga ajo datë, OIRK mbetet në pritje të një njoftimi zyrtar lidhur me finalizimin e procesit.

Theksojmë se OIRK ka treguar vazhdimisht gatishmëri për bashkëpunim me Ministrinë dhe KMTHO-në, duke iu përgjigjur kërkesave dhe duke ofruar dokumentacionin e nevojshëm, me qëllim përfundimin e procesit të financimit dhe sigurimin e funksionimit të qëndrueshëm të Odës.

Në këtë drejtim, rikujtojmë se, sipas neneve 41 dhe 42 të Ligjit Nr. 08/L-012, gjatë periudhës së përkohshme të themelimit parashihet mbështetja financiare e Odës nga Ministria në formë të grantit, ndërsa të hyrat vetanake të Odës, të mbledhura nga anëtarësia që nga themelimi, ruhen në mirëbesim në Thesar, në përputhje me dispozitat ligjore.

Pavarësisht përpjekjeve për të vazhduar funksionimin me mjetet dhe mundësitë në dispozicion, mungesa e financimit tashmë ka shkaktuar vështirësi serioze dhe ka kufizuar ndjeshëm veprimtarinë e Odës, konkretisht:

- Mospagesën që nga korriku 2026 të pagave të administratës, kompensimit të Kryetarit, si dhe mëditjeve dhe kompensimeve të Bordit Drejtues, komisioneve dhe grupeve punuese;
- Grevën e administratës, e cila ishte paralajmëruar të fillonte më 1 tetor 2026, por ishte shtyrë me mirëkuptimin e punonjësve gjatë muajit tetor, në pritje të realizimit të grantit. Me mosrealizimin e financimit, greva tashmë ka filluar;
- Ndërhyrjen e Inspektoratit të Punës, i cili, përmes Raportit Zyrtar Nr. 1207-216/2026, datë 03.11.2026, ka konstatuar parregullsi lidhur me mospagesën e pagave dhe ka kërkuar

përmbushjen e detyrimeve brenda tri ditësh nga pranimi i raportit, duke paralajmëruar inicimin e procedurës kundërvajtëse në gjykatë;

- Rrezikun e ndërprerjes së shërbimeve elektronike, ku, pas kalimit të afatit për pagesën vjetore të mirëmbajtjes mbi dy muaj më parë dhe disa vazhdimeve të përkohshme mujore, më 12 nëntor 2026 pritet deaktivizimi i postës elektronike zyrtare të Odës;
- Paralajmërimin nga kompania e kontraktuar për ndërprerjen e prodhimit të licencave profesionale, si rezultat i detyrimeve të papaguara të akumuluara për një periudhë të gjatë;
- Detyrimet e papaguara për energji elektrike, ujësjellës, telekomunikim dhe shpenzime të tjera të domosdoshme për funksionimin e Odës;
- Pamundësinë e realizimit dhe përmbylljes së aktiviteteve dhe detyrimeve të parapara me Planin Vjetor të Punës së OIRK-së për vitin 2026.

Gjithashtu, për shkak të pamundësisë financiare, Bordi Drejtues ka vendosur anulimin e pjesëmarrjes së delegacionit të OIRK-së në Asamblenë e Përgjithshme të ECEC-së (European Council of Engineers Chambers), më 6 dhe 7 nëntor 2026, në Dubrovnik.

Dëshirojmë të theksojmë se pezullimi i përkohshëm i aktiviteteve nuk është një vendim i dëshiruar dhe as masë proteste ndaj Ministrisë. Përkundrazi, OIRK mbetet e përkushtuar ndaj bashkëpunimit institucional dhe gjetjes së një zgjidhjeje të përbashkët. Megjithatë, mungesa e mjeteve financiare dhe pamundësia për përmbushjen e detyrimeve themelore kanë krijuar rrethana në të cilat vazhdimi i funksionimit të rregullt është bërë objektivisht i pamundur.

Kjo situatë nuk prek vetëm funksionimin e brendshëm të Odës, por ndikon edhe në ushtrimin e kompetencave publike të përcaktuara me ligj, ofrimin e shërbimeve për inxhinierët e licencuar dhe funksionimin e rregullt të sistemit të licencimit profesional në Republikën e Kosovës.

Gjithashtu, Bordi Drejtues do t'i njoftojë zyrtarisht të gjithë anëtarët e OIRK-së për vendimin e pezullimit të përkohshëm të aktiviteteve dhe shërbimeve administrative të Odës, duke i informuar për gjendjen financiare, rrethanat që kanë çuar në marrjen e këtij vendimi, si dhe pasojat që mund të shkaktojë ndërprerja e shërbimeve. Njoftimi do të bëhet përmes kanaleve zyrtare të komunikimit të Odës, me qëllim sigurimin e transparencës institucionale dhe informimin në kohë të anëtarësisë.

Në frymën e bashkëpunimit të deritanishëm, kërkojmë mirëkuptimin dhe angazhimin e Ministrisë dhe Komisionit Ministror për Themelimin e Odave për finalizimin sa më të shpejtë të Memorandumit të Mirëkuptimit dhe realizimin e grantit për vitin 2026, si dhe njoftimin zyrtar për afatin e pritshëm të realizimit të financimit.

OIRK mbetet plotësisht e gatshme për çdo takim, sqarim apo veprim shtesë që mund të ndihmojë në përmbylljen e këtij procesi. Qëllimi ynë i përbashkët është sigurimi i funksionimit të rregullt të Odës dhe përmbushja e përgjegjësive të saj ligjore dhe profesionale, në interes të anëtarësisë dhe institucioneve të Republikës së Kosovës.

Duke marrë parasysh rrethanat e krijuara dhe pasojat financiare e institucionale që tashmë kanë filluar të shfaqen, shpresojmë në trajtimin me prioritet të kësaj çështjeje dhe në gjetjen e një zgjidhjeje sa më të shpejtë, e cila do të mundësonte rifillimin e aktiviteteve dhe shërbimeve të Odës.

Me respekt,

BORDI DREJTUES
Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (OIRK)

Bashkëngjitur:

1. Vendimi i Bordit Drejtues të OIRK-së, Nr. 19-BD/2026
2. Raporti Zyrtar i Inspektoratit të Punës, datë 03.11.2026.